

LIGJ
Nr.9201, datë 4.3.2004

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS TË HUNGARISË PËR ZGJIDHJEN E BORXHIT TË TRASHËGUAR TË SHQIPËRISË KUNDREJT HUNGARISË”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Hungarisë për zgjidhjen e borxhit të trashëguar të Shqipërisë kundrejt Hungarisë”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekreten nr.4184, datë 29.3.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

MARRËVESHJE

NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS TË HUNGARISË MBI ZGJIDHJEN E BORXHIT TË TRASHËGUAR TË SHQIPËRISË KUNDREJT HUNGARISË

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë (Pala shqiptare) dhe Qeveria e Republikës së Hungarisë (Pala hungareze, së bashku të quajtura Palët) në interes:

- të vendosjes dhe të nxitjes së zhvillimit të mëtejshëm të bashkëpunimit tregtar dhe financiar, në favor të të dy vendeve dhe

- të zgjidhjes së borxhit të jashtëm të Palës shqiptare kundrejt Palës hungareze, bien dakord të përfundojnë Marrëveshjen e mëposhtme, lidhur me zgjidhjen e borxhit të trashëguar të Shqipërisë (borxhi) kundrejt Hungarisë.

Neni 1

Shuma e borxhit

Palët nënvizojnë se borxhi i Palës shqiptare kundrejt Palës hungareze arrin në 14 178 946.06 USD (katërmëdhjetë milionë e njëqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e nëntëqind e dyzet e gjashtë pikë zero gjashtë) dhe që përbëhet nga:

Shuma e borxhit prej 3 034 840.82 rubla klering, i cili duhej shlyer deri më 30 qershor 1991.

Kjo shumë është konvertuar nga Palët në përputhje me marrëveshjen e nënshkruar më 12 dhjetor 1990 (1 rubël klering = 0.8 USD) dhe rezulton në 2 427 872.66 USD.

Shuma prej 11 751 073.40 USD, që rrjedh nga eksportet hungareze të grurit, të kryera ndërmjet 23 nëntorit 1991 dhe 16 gushtit 1992 dhe që kanë mbetur pa u paguar.

Neni 2

Afatet dhe mënyra e pagesës

Pala shqiptare merr përsipër të paguajë borxhin me anë të eksportit të mallrave në Hungari në shumën prej 1 417 894.60 USD (angazhimi vjetor i eksportit) për çdo vit gjatë një periudhe kalendarike prej dhjetë vjetësh, duke filluar nga viti 2004.

Eksportet shqiptare, si shlyerje e borxhit, do të realizohen nëpërmjet kontratave të shitblerjes ndërmjet kompanive të autorizuara, të cilat do t'ia paraqesin për miratim kontratat e tyre autoriteteve përkatëse.

Neni 3

Realizimi i pagesës së borxhit

Ministria e Financave e Shqipërisë do t'i paguajë eksportuesit shqiptar vlerën e mallrave të eksportuara. Importuesi hungarez do t'i paguajë vlerën e mallrave të blera (importuara) Thesarit të shtetit hungarez.

Ministria e Financave e Shqipërisë dhe institucioni i autorizuar hungarez, brenda 60 ditëve nga nënshkrimi i kësaj Marrëveshjeje, do të nënshkruajnë një marrëveshje lidhur me mënyrën e regjistrimit të pagesave, përfshirë këtu edhe llogaritjen, kontabilizimin dhe pagesat e interesit, si edhe rakordimin e bilancit të eksporteve shqiptare në fund të çdo viti. Të gjitha këto veprime do të kryhen në USD.

Ministria e Financave e Shqipërisë dhe institucioni i autorizuar hungarez në të njëjtën kohë do të pakësojnë borxhin e Palës shqiptare me vlerën e eksporteve shqiptare të realizuara dhe me pagesat e kryera në USD në përputhje me nenin 5.

Neni 4

Interesi

Pala hungareze fal të gjitha interesat e borxhit të Palës shqiptare të llogaritura deri në datën e nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje.

Palët bien dakord që duke filluar nga data e nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje, Pala shqiptare merr përsipër të paguajë çdo gjashtë muaj interes në “cash”, të llogaritur në bazë të Liborit gjashtëmujor, në bazë të numrit kalendarik të ditëve dhe të vitit prej 360 ditësh.

Neni 5

Raste të veçanta të pagesës

Në rast se në një vit kalendarik ekzistojnë mundësi për të tejkaluar kufirin e eksporteve të vendosur në nenin 2, do të realizohen eksporte shtesë. Në qoftë se këto eksporte shtesë arrijnë 50% të angazhimit vjetor të eksporteve, borxhi do të pakësohet me 15% të vlerës së eksporteve shtesë (bonus). Në rast se eksportet shtesë janë nën 50%, bonusi do të jetë 7.5%.

Në rastet kur, për ndonjë arsye, në një vit kalendarik vlera e eksporteve shqiptare nuk do të arrijë shumën e përcaktuar në nenin 2, Pala shqiptare është e detyruar të paguajë në “cash”, jo më vonë se 30 qershori i vitit pasardhës, shumën që nuk është realizuar. Në qoftë se kjo pagesë nuk do të realizohet brenda kësaj periudhe, Pala shqiptare është e detyruar të paguajë interes-vonesat të llogaritura me Libor +1% mbi vlerën e eksporteve të parealizuar.

Neni 6

Të tjera

1. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi, pasi të plotësohen të gjitha procedurat e nevojshme ligjore dhe Palët të kenë njoftuar zyrtarisht për këtë njëra-tjetrën. Marrëveshja do të jetë në fuqi derisa Palët të kenë shlyer të gjitha detyrimet që rrjedhin prej saj.

2. Kjo Marrëveshje nuk do të amendohet pa miratimin me shkrim të Palëve.
3. Kjo Marrëveshje është bërë në dy kopje origjinale në gjuhën angleze.

Tiranë, më 17 dhjetor 2003